SAFETY GALA ALBANIA

Mr. Mariel Halilaj

Director
Ministry of Economy,
Culture and Innovation



SAFETY GALA ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

ZHVILLIMET POZITIVE NË FUSHËN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

I. REKOMANDIMET E BE-SË DHE NDRYSHIMET STRUKTURORE

Rekomandimet

- Të zhvillohet një strategji të re për shëndetin dhe sigurinë në punë në përputhje me prioritetet e reja strategjike të BE-së për SSHP, me fokus në forcimin e kapaciteteve institucionale politikëbërëse dhe zbatuese, për të zbatuar në mënyrë efektive pajtueshmërinë me legjislacionin.
- Të vazhdohen përpjekjet gjithëpërfshirëse (arsimi gjithëpërfshirës, zbutja e varfërisë, puna e denjë për të rriturit, pajtueshmëria me ligjin, një sistem më i fortë monitorimi).
- Të vazhdohen përpjekjet për forcimin e kapaciteteve të Inspektoratit Shtetëror të Punës veçanërisht për veprimtaritë e inspektimit, për sa i përket personelit dhe burimeve financiare e fizike, përfshirë stokun e automjeteve.

Ndryshimet strukturore

Zhvillimi dhe monitorimi i politikave shtetërore mbi arsimin dhe formimin profesional, punësimin, emigracionin dhe imigracionin e punës, sigurimet shoqërore, ***"marrëdhëniet e punës, dialogun social, sigurinë, shëndetin dhe inspektimit të punës",*** kanë qënë në fushën e përgjegjësisë të disa ministrive.

Këto ndryshime janë reflektuar edhe me ndikime shpesh herë jopozitive në fushën e ***"sigurisë dhe shëndetit në punë"***. Gjatë dekadës së fundit siguria dhe shëndëti në punë, ka qënë dhe është në fushën e përgjegjësisë së këtyre institucioneve:

- ***Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (2014 - 2017)***
- ***Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2017-2023)***
- ***Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (2024 - aktualisht)***

II. DOKUMENTI I POLITIKAVE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË 2024 - 2030 DHE PLANI I VEPRIMIT

Përse Dokument i Politikave?

Legjslacioni shqiptar, përcakton hartimin e dokumentit të politikave në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe ngarkon minstrin përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë për hartimin e tij, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe në këshillim me institucionet dhe përgjegjësit e tjerë në këtë fushë, si dhe me partnerët socialë.

(Ligji nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", i ndryshuar, - gërma "a", pika 2, neni 38)

Kuadri i strategjik i Shqipërisë i konkretizuar në "Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 - 2030", nuk përcakton hartimin i një strategjie për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, por ajo konsiderohet si dokument plotësues strategjik i "Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030", ndaj dhe forma e hartimit të këtij dokumenti do të jetë "Dokument i Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2024 - 2030".

GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS

“Dokumenti i Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Plani i Veprimit” është realizuar nga ***Grupi Ndërinstitucional të Punës,*** në bashkëpunim me ***ekspertë ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës*** (ONP/ ILO) dhe ***Organizatës Botërore të Shëndetësisë*** (OBSH/WHO).

PËRPUTHSHMËRIA

- Strategjia Globale e ILO-s për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024-2030;
- Rezolutat e miratuara në Konferencën e 110-të Ndërkombëtare të Punës
- Konventat Themelore të ONP/ILO-s për SSHP (nr. 155 dhe 187);
- Korniza Strategjike e BE-së për SSHP 2021-2027;
- Direktiva e Këshillit të BE-së 89/391/EEC e dates 12 Qershor 1989
- Ligji nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”
- Programi Vendor për Punën e Denjë për Shqipërinë 2023-2026;
- Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë 2023-2030;
- Dokumenti i Politikave për Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, 2016-2020.

QËLLIMI

Të krijojë një vizion të qartë për të ardhmen, të zbërthyer në politika, prioritete e objektiva strategjikë dhe masa të mirëpërcaktuara, të cilat mund të zbatohen në mënyrë efektive, duke zhvilluar një sistem më të dobishëm inspektimi dhe menaxhimi të SSHP.

Të vazhdojë reforma në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, reflektimin e ndryshimeve që kanë ndodhur në botën e punës gjatë viteve të zbatimit të dokumentit të mëparshëm *"Dokumentit Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2016-2020"*.

REZULTATET E PRITSHME

- Realizimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune si një e drejtë themelore.
- Përmirësimi i mjedisit të punës duke zbatuar një qasje parandaluese, sistematike dhe të mirëkoordinuar për administrimin e shërbimeve të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Ulja e shkallës së aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.
- Nxitja e një kulture parandaluese të sigurisë dhe shëndetit.

DOKUMENTI I POLITIKAVE MBËSHTETET NË 3 SHTYLLA KRYESORE

Shtylla A - Përshtatja e institucioneve dhe politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë me sfidat aktuale dhe të së nesërmes

Shtylla B: Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë për kushte të mira pune

Shtylla C: Bërja e SSHP-së prioritet dhe rritja e ndërgjegjësimit për SSHP-në për të garantuar kushte të mira pune

PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE

Ky dokument përbëhet nga 5 kapituj, Plani i Veprimit dhe disa anekse si më poshtë:

- **Kapitulli 1:** Politikat e sigurisë dhe shëndetit në punë
- **Kapitulli 2:** Vizioni dhe përparësitë strategjike
- **Kapitulli 3:** Objektivat e politikave
- **Kapitulli 4:** Kostot e vlerësuara dhe burimet e financimit
- **Kapitulli 5:** Mekanizmat e llogaridhënies, monitorimit dhe vlerësimit
- **Plani i Veprimit**
- **Anekse**

Për të realizuar objektivin gjithëpërfshirës, Dokumenti i Politikave mbështetet në tre shtyllat themelore të cilat zbërthehen në:

- Prioritetet strategjike
- Treguesit e ndikimit
- Objektivat strategjike
- Aktivitetet/ Veprimet

SHTYLLA A

"Përshtatja e institucioneve dhe politikave të sigurisë dhe shëndetit në punë ndaj sfidave aktuale dhe të së nesërmes"

Prioriteti Strategjik A1

"Përmirësimi i Kuadrit Ligjor të SSHP"

- Objektivi A 1.1

Ngritja dhe funksionimi i rregullt i Këshillit ndërministror për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë (KNSSHP), sipas Ligjit për SSHP.

- Objektivi A 1.2

Përafrimi i kuadrit rregullator të vendit për procesin e anëtarësimit në BE

Prioriteti Strategjik A2

"Përmirësimi i sistemeve të hetimit dhe raportimit të aksidenteve dhe sëmundjeve"

- Objektivi A 2.1

Zhvillimi i një Regjistri Kombëtar të Aksidenteve dhe Sëmundjeve Profesionale (RKASP/NROAD) bazuar në kërkesat ESAW dhe EODS

Prioriteti Strategjik A3

"Krijimi i një sistemi për trajnimin, certifikimin dhe licencimin e ekspertëve dhe shërbimeve të SSHP"

- Objektivi A 3.1

Zbatimi i Programit të Trajnimit dhe Sistemi i Regjistrimit i krijuar dhe funksionuar për certifikimin e profesionistëve të SSHP dhe licencimin e shërbimeve

SHTYLLA B

"Forcimi i qeverisjes dhe menaxhimit të institucioneve të sigurisë dhe shëndetit në punë për kushte të mira pune"

Prioriteti Strategjik B1

"Forcimi i kapaciteteve të institucioneve politikëbërëse dhe zbatuese"

- Objektivi B 1.1

Rritja e kapaciteteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për SSHP

- Objektivi B 1.2

Zhvillimi dhe zbatimi i kurseve për SSHP dhe programeve të trajnimit në shëndetin në punë

Prioriteti Strategjik B2

"Rritja e kapaciteteve të institucioneve zbatuese"

- Objektivi B 2.1

Kapacitete të zgjeruara të ISHPSHSH

- Objektivi B 2.2

Kapacitete të zgjeruara të ISHSH

Prioriteti Strategjik B3

"Përmirësimi i Dialogut Social në Sigurinë dhe Shëndetin në Punë"

- Objektivi B 3.1

Ngritja e Komiteteve "ad hoc" trepalëshe specifike për sektorin dhe promovimi i funksionimit të rregullt të komiteteve të SSHP në nivel ndërmarrje

SHTYLLA C

“Bërja e SSHP-së prioritet dhe rritja e ndërgjegjësimit për SSHP-në për të garantuar kushte të mira pune”

Prioriteti Strategjik C1

“Promovimi i një kulture parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë nëpërmjet shpërndarjes së informacionit dhe ndërgjegjësimit”

- Objektivi C 1.1

Promovimi i një kulture parandaluese në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

Prioriteti Strategjik C2

“Bërja e arsimit për SSHP prioritet në të gjitha nivelet/ Prioriteti i arsimit për SSHP në të gjitha nivelet arsimore”

- Objektivi C 2.1

Integrimi i SSHP në të gjitha nivelet e shkollimit, formimit profesional dhe arsimit të lartë

KOSTOT E VLERËSUARA DHE BURIMET E FINANCIMIT

Burimet kryesore për financimin e planit të veprimit do të jenë:

- Buxhetet e vlerësuara dhe të miratuara për ministritë përkatëse dhe programet buxhetore, të parashikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026

- Kontributi i donatorëve potencialë që operojnë në fushën e SSHP në vend.

LLOGARIDHËNIA, MEKANIZMAT E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT

Ky dokument politikash dhe plan veprimi është produkt i përpjekjeve ndërsektoriale dhe për rrjedhojë, koordinimi dhe Monitorimi dhe Vlerësimi i tij do të koordinohen nga të gjitha palët përkatëse të përfshira.

Këshilli Ndërministror i SSHP-së - OSHIMC do të jetë organi mbikëqyrës i zbatimit të strategjisë, i cili do të monitorojë dhe mbikëqyrë zbatimin e aktiviteteve të përfshira në këtë Plan Veprimi për SSHP.

PLANI I VEPRIMIT

Përmbajtja

Plani i Veprimit përmban tre shtyllat themelore të zbërthyera në:

- Prioritetet strategjike
- Treguesit e ndikimit
- Objektivat strategjike
- Aktivitetet/ Veprimet

Plani i Veprimit paraqet në mënyrë grafike rubrikat si më poshtë:

- Aktiviteti dhe Rezultati, Veprimtaria dhe përfundimi
- Institucioni përgjegjës
- Afati kohor
- Burimi financiar
- Konteksti dhe problematika
- Objektivi afatmesëm
- Objektivi i synuar

Aktualisht, është drejt përfundimit drafti përfundimtar i Dokumentit të Politikave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë 2024-2030 dhe Planit të Veprimit, dhe më pas do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

- Dokumenti është publikuar për Konsultim Publik dhe dërguar për mendim tek ministritë e linjës dhe institucionet e përfshira.
- Reflektimi i komenteve dhe sugjerimeve të përfituara gjatë procesit të Konsultimit Publik dhe mendimeve të institucioneve.
- Dërgimi për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave.
- Miratimi i Dokumentit të Politikave për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030 dhe Planit të Veprimit.
- Zbatimi i Planit të Veprimit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë 2024 - 2030.

III. PLANET E ARDHSHME

Në të ardhmen Shqipëria, për shëndetin dhe sigurinë në punë, do të:

- ***Shtojë përpjekjet për të siguruar përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së.***

- ***Punojë për modernizimin e legjislacionit bazuar në ndryshimet që kanë ndodhur në botën e punës, në bashkëpunim me Partnerët Socialë, aktorë të tjerë privatë dhe organizata joqeveritare.***

- ***Autoritetet do të forcojnë kapacitetet e tyre institucionale dhe proceset e inspektimit.***

- ***Shqipëria do të miratojë dhe fillojë zbatimin e Strategjinë e re për sigurinë dhe shëndetin në punë 2024-2030, e cila është në përputhje me kuadrin strategjik të BE-së për shëndetin dhe sigurinë në punë 2021-2027 dhe prioritetet e tij.***

Falëminderit!